

Besnik Ismailati
Qytetar Nderi, Bashkia Libohovë

LIBOHOVA DHE EUROPA

Nga trashëgimia historike drejt sfidave të së ardhmes

Rrëzë malit të Buretos, në një pozicion që mbizotëron luginën e Drinos, Libohova ka qenë prej shekujsh një qendër e rëndësishme historike, kulturore dhe shoqërore në jug të Shqipërisë. Historia, pozita gjeografike dhe personalitetet e saj e kanë lidhur këtë trevë me zhvillimet politike, kulturore dhe shoqërore të hapësirës evropiane. Sot, ndërsa Shqipëria vijon rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, Libohova përballet me sfidën për ta kthyer këtë trashëgimi në një mundësi konkrete zhvillimi ekonomik dhe shoqëror.

Lidhjet e Libohovës me hapësirën evropiane kanë rrënjë të hershme. Që në lashtësi, kjo trevë, në afërsi të qendrave të rëndësishme antike të luginës së Drinos, ishte pjesë e një hapësire me marrëdhënie të gjera kulturore dhe ekonomike mesdhetare. Në shekujt XIX dhe XX, këto lidhje morën një dimension të ri përmes arsimimit dhe veprimtarisë së personaliteteve libohovite në qendra të rëndësishme të kohës, si Janina, Parisi, Londra, Roma dhe Vjena. Përvojat e tyre ndikuan në zhvillimin e mendimit për shtetin modern, diplomacinë, arsimin dhe emancipimin shoqëror shqiptar. Ndërkohë, sarajet, familjet e njohura dhe traditat qytetare të Libohovës dëshmojnë për një histori komunikimi me botën e jashtme dhe për një kulturë të konsoliduar mikpritjeje.

Kjo trashëgimi njerëzore vijon të përfaqësohet nga personalitete me origjinë libohovite, të cilët kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin kontribut në politikë, drejtësi, shkencë, art, kulturë dhe sport. Studimet, veprimtaria profesionale dhe krijimtaria e tyre kanë ndihmuar në përfaqësimin e vlerave shqiptare në hapësirën ndërkombëtare. Krahas kësaj pasurie njerëzore, Libohova ruan edhe një trashëgimi të vyer të jetës qytetare dhe familjare. Mikpritja, traditat, gastronomia, zejet, produktet bujqësore dhe blegtorale përbëjnë vlera autentike, të cilat mund të shërbejnë si bazë për zhvillimin e turizmit kulturor dhe agroekoturizmit.

Megjithatë, perspektiva evropiane e Shqipërisë e vendos edhe Libohovën përballë sfidave të rëndësishme. Shpopullimi, emigracioni dhe largimi i të rinjve ndikojnë drejtpërdrejt në jetën ekonomike e shoqërore, duke pakësuar burimet njerëzore dhe

duke vështirësuar vazhdimësinë e traditave dhe veprimtarive prodhuese. Një sfidë tjetër është rritja e kapaciteteve administrative dhe profesionale për të përfituar nga programet dhe fondet evropiane të zhvillimit. Në kushtet e reja të organizimit të qeverisjes vendore, rëndësi të veçantë merr evidentimi dhe përfaqësimi i veçorive, nevojave dhe mundësive të Libohovës në planet dhe programet e zhvillimit territorial, ekonomik dhe social. Ruajtja e identitetit historik dhe kulturor të kësaj treve duhet të jetë pjesë e pandarë e këtij procesi.

Një vend të rëndësishëm në perspektivën e zhvillimit të Libohovës zënë vlerat bujqësore dhe natyrore. Ullinjtë shekullorë, vreshtat, pemëtaria, kultivimi i drithërave dhe i kulturave të tjera bujqësore, blegtoria, si dhe pasuria e bimësisë natyrore të malit Bureto, përfshirë bimët mjekësore dhe aromatike, përbëjnë një trashëgimi të çmuar dhe një bazë të rëndësishme për ekonominë e territorit. Veçanërisht, ullinjtë shekullorë përfaqësojnë jo vetëm një pasuri prodhuese, por edhe një dëshmi të vazhdimësisë së marrëdhënieve të njeriut me natyrën dhe tokën ndër breza. Këto pasuri nuk duhen parë vetëm si tradita të trashëguara, por si burime me mundësi të reja ekonomike, përmes rritjes së prodhimit, përmirësimit të cilësisë, përpunimit, standardizimit dhe promovimit të produkteve vendase. Ndërthurja e bujqësisë me gastronominë, trashëgiminë kulturore dhe peizazhin natyror krijon gjithashtu kushte të favorshme për zhvillimin e agroekoturizmit.

Shfrytëzimi i këtyre mundësive kërkon vëmendje dhe përgjegjësi të veçantë nga strukturat e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet e specializuara, fermerët dhe sipërmarrjen private. Është e nevojshme që veçoritë dhe pasuritë e Libohovës të përfshihen në politikat dhe programet e zhvillimit social-ekonomik, duke siguruar mbështetje për prodhuesit, mbrojtjen e burimeve natyrore, modernizimin e veprimtarive bujqësore dhe krijimin e mundësive për përpunimin e tregtimin e produkteve vendase. Përafrimi me standardet dhe politikat e Bashkimit Evropian kërkon përmirësimin e cilësisë, gjurmueshmërinë dhe sigurinë ushqimore të produkteve, organizimin e fermerëve dhe rritjen e aftësive për të përfituar nga programet evropiane të zhvillimit rural. Këto janë sfida që kërkojnë planifikim, bashkëpunim institucional dhe një vizion afatgjatë për zhvillimin e territorit.

Historia e Libohovës dëshmon se lidhjet me Evropën nuk janë një aspiratë e re, por pjesë e një përvoje të gjatë historike, kulturore dhe njerëzore. Sfida e sotme është që kjo pasuri të mos mbetet vetëm një kujtim i së kaluarës, por të shndërrohet në një pikënisje për zhvillimin e së ardhmes. Duke ruajtur identitetin.